



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.308/2024

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.U "H., Jugor" Sh.a., me numër të biznesit .., me seli në P., rr. "W..., C...", p.n, kundër debitorit Q. A., me adresë në D., fshati Z., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arlind Rifaj, avokat nga Dragashi, me objekt kontesti borxh në bazë të dokumentit të besueshëm, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.11.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike përmbarimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Prizren, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### A r s y e t i m

Te Përmbaruesi Privat M. S. R., në P., kreditori K.R.U "H. Jugor" Sh.a., me seli në P., ka paraqitë propozim për përmbarim ndaj debitorit Q. A., me adresë në D., fshati Z., për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 1.804.39 €.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit K.R.U "H., Jugor" Sh.a, përmes Urdhrit Përmbarimor P.nr.620/21, të datës 03.11.2021, ka lejuar përmbarimin kundër debitorit Q. A., lidhur me çështjen përmbarimore borxh sipas dokumentit të besueshëm.

Debitori brenda afatit të paraparë ligjor ka paraqitur prapësim ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.620/21 të datës 03.11.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat M. R., dhe lënda është transferuar në Gjykatën Themelore në Prizren, për vendosje sipas prapësimit të debitorit.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.55/2023 të datës 25.01.2024, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur për prapësimin e palës debitore Q. A., nga fshati Z., Komuna D., i ushtruar kundër urdhrin për përmbarim P.nr.620/21, të datës 03.11.2021, të Përmbaruesit

Privat M. R. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkesat e lëndës PP.nr.55/2023, do ti dërgohen në kompetencë Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.751/24, të datës 22.10.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen përmbartimore në mes të kreditorit K.R.U "H. Jugor" me seli në P., kundër debitorit Q. A., nga D.. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që, për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori K.R.U "H. Jugor" Sh.a, me seli në P., ka paraqitë propozim për përmbartim ndaj debitorit Q.A., me adresë në D., fshati Z., për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 1.804.39 €. Pastaj Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit K.R.U "H. Jugor" Sh.a, përmes Urdhrit Përmbartimor P.nr.620/21, të datës 03.11.2021, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit Q. A., lidhur me çështjen përmbartimore borxh sipas dokumentit të besueshëm, ndaj këtij urdhri përmbartimor debitori ka paraqitë prapësim dhe lënda është transferuar në Gjykatën Themelore në Prizren, për vendosje sipas prapësimit të debitorit. Gjykata Themelore në Prizren pas marrjes së shkresave të lëndës nga përmbartuesi, me aktvendimin PPP.nr.55/2023, të datës 25.01.2024, është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike përmbartimore me kompetencë lëndore për të vendosur është Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për arsye se:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“1.Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe”*. Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet se: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*.

Me nenin 13 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, të Ligjit Nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me*

*ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate...”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike - përmbare, sipas prapësimit të debitorit është Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm. Kjo për faktin se me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cituara më lart erdhi në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit dhe sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me persona juridik, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare. Në lidhje me këtë, faktin se debitori është person fizik, kjo dëshmohet nga fatura e konsumatorit, e që sipas dispozitave ligjore të lartcekura, është kusht që palët të jenë persona juridik dhe njëkohësisht kontesti të ketë të bëjë me çështje të ndërsjella tregtare, pra të plotësohen këto dy kushte në mënyrë kumulative, nëse njëra nga këto mungon atëherë nuk kemi të bëjmë me çështje tregtare dhe rrjedhimisht nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë dhe të Dytë, për të gjykuar në këtë çështje juridike.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**CN.nr.308/2024, datë 21.11.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
Lumni Sallauka